



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 228 Prot.

Tiranë, më datë 08.05.2026

**VENDIM**

**Nr. 48, datë 08.05.2026**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 08.05.2026, Këshilli Teknik:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Rindërtimi i çatisë së banesës së Z. Edmond dhe Luan Zotkaj, lagja 28 Nëntori – Berat”, Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike Berat, me aplikues Z. Ogrri Mane dhe zhvillues **Z. Edmond Zotkaj**;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikqyren sipas VKM Nr. 827, datë 28.12.2023, “Për deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër Historike” të një zone në Qytetin-muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”, neni 13, pika 3, dhe të monitorohen nga DRTK Berat;
3. Subjekti zhvillues të vijoje me procedurën ligjore për miratim sipas Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dajeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

